

RESBLOCK

Grëshirë poliuretanike prej një përbërësi pa solventpër t'u përdorur për injeksione kundër depërtimeve të ujit në strkturat prej betoni, tullash e tjegullash

Karakteristikat

RESBLOCK është një prepolimer prej një përbërësi, pa solvente, ideal për të mbyllur e vulosur në mënyrë të papërshekueshme si dhe për të bllokuar depërtimet e vogla e të mëdha të ujit. **RESBLOCK** reagon me ujin duke gjeneruar një shkumë poluretanike/poliuree. Me t'u forcuar nuk ndryshon në vëllim edhe kur është në kontakt të vazhdueshëm me ujin.

Fusha e përdorimit

RESBLOCK rekomandohet për mbylljen e të çarave, plasaritjeve dhe pjesëve të lagështa në strukturat prej betoni, me tulla apo tjegulla. Me të mund të trajtohen edhe humbje të mëdha apo në presion.

Mënyra e përdorimit

Përziej **RESBLOCK** me sasinë e katalizatorit që konsiderohet sasia e duhur për punën që duhet kryer në një enë të pastër e të thatë (shiko të dhënat teknike dhe aplikuese). Përzierja mbetet e patrazuar për të paktën 10 orë pa bërë shtesa për të arritur një viskozitet më të lartë. Produkti i katalizuar mund të nxjerrë në sipërfaqe, kur ekspozohet jashtë, një cipë që krijohet si rezultat i reagimit të produktit me lagështirën, por kjo nuk ndikon as aftësinë pompuese të përzierjes dhe as riaktivizimin e tij me ujin, pasi të jetë injektuar.

RESBLOCK mund të injektohet me një pompë me dorë ose automatike, duke përdorur packer me bashkime të shpejta të pozicionuara që më parë në zonën apo çarjen që duhet mbyllur. **RESBLOCK**, me t'u injektuar reagon me ujin duke u rritur në vëllim dhe forcohet.

Ndryshe nga produktet me dy përbërësa, **RESBLOCK** nuk forcohet brenda tubave të dërgimit, pasi reagimi i tij varet nga kontakti me ujin/lagështirën.

Në fund të punimeve ose me t'u pezulluar gjatë injektimit, mirë është të shpëlahet si duhet pompa dhe tubat e dërgimit me solvent nitrik në mënyrë që të shmangët çdo bllokim i tyre i mundshëm.

Të dhëna teknike dhe aplikative

Injektimi i RESBLOCK

Ngjyra	Kafe
Dendësia në 25° C	1.05 kg/l
Pika e ndezjes	>100° C
Viskoziteti në 15 ° C	500m/Pas
Periudha e ruajtjes	6 muaj

Katalizatori RESBLOCK

Ngjyra	e zverdhur
Dendësia në 25° C	0.96 kg/l
Pika e ndezjes	102° C
Vlera e pH në 20° C	<10.5

Shpejtësia e reagimit

% e katalizatorit	Reagimi në 5° C Fillim/fund	Reagimi në 10° C Fillim/fund	Reagimi në 15° C Fillim/fund	Reagimi në 25° C Fillim/fund
10	11"/55"	10"/45"	09"/40"	08"/35"
15	10"/40"	09"/35"	08"/30"	07"/25"

Paralajmërime

- Produkti është i ndjeshëm ndaj lagështirës atmosferike dhe temperaturës. Të ruhet gjithmonë në një temperaturë 10-30° C.
- Të përdoret menjëherë pas hapjes ose të mbahet i ruajtur në azot
- Të pastrohet pompa dhe veglat me pastruesin përkatës.
- Gjatë përdorimit të respektohen rregullat e përgjithshme të sigurisë relative të manipulimit të produkteve kimike; të mos hahet/pihet gjatë përdorimit të materialit; të lahen duart para ngrënies/pirjes; të mos thithen avujt e produktit e të shmangët një kontakt i gjatë me lëkurën. Të mos gëlltitet. **RESBLOCK** të përdoret në një mjedis ku ka ajrosje.